



VENDIM

Nr 86, Datë 30.06.2015

PËR

FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LICENSIMIN E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 2, gërma “c”; 16; 37, pika 2 gërma “ç” dhe 39 pika 3, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5 pika 1, gërma “f”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21 datë 18.03.2009 të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 30.06.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për furnizimin e klientëve të kualifikuar (neni 9 , pika 4/9, germa “a”);
- Nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar, (neni 9, pika 4/9, germa “b”) dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga Shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9 , pika 4/9, germa “c”),

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë / të Pjesëshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI